



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:108527  
Datë: 08.09.2021  
Numri i dokumentit: 02154659

**PA1.nr.1023/2021**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.K., nga fshati ..., komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.417/2021, të datës 21.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.09.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.417/2021, të datës 21.06.2021, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.417/2021, të datës 21.06.2021, është shpallur fajtor i akuzuari F.K., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par. 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 100 Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë në shumën prej 100 Euro, nuk e paguan në afatin e përcaktuar, atëherë i njëjti dënim do ti zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg me nga 20 Euro, në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPK, si dhe dënimi me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari, A.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1039/2021, të datës 20.08.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.**

Meqenëse aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktvendimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se dënimi i shqiptuar është shumë i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer penale, e sidomos duke pasur parasysh pasojat konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat rënduese të cilat pasqyrohen në faktin se veprat penale të vjedhjes janë në rritje të përhershme dhe të konsiderueshme, dhe se në rastin konkret bëhet fjalë për pasurinë private dhe se vjedhja është kryer në dëm të kësaj pasurie, e po ashtu nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur as shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj konsiderojmë që me dënimin e shqiptuar nuk do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitat ligjore.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetur gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, për veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPPK, ashtu që si

rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka qenë korrekt gjatë gjykimit, si dhe ka shprehur pendimin e tij për veprën e kryer penale, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të së njëjtës, kurse nga ankesa e prokurorisë, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1023/2021, të datës 06.09.2021**

**Sekretarja juridike,**  
**Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Zyhdi Haziri**